



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
27.09.2022**

Me datë 27.09.2022, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija, Teuta Zaja, Bledianë Nika, Nersada Mandija, Ermin Gruda, Aurora Dibra, Tereze Brigja, Diana Murici, Sabahete Lishi, Vjollca Petani, Daniela Jakoja, Ardit Spahija, Dhurata Tyli, Sabina Danaj, Donika Ndoja, Kristi Agnes Shllaku, Valbona Doniku, Suada Selimaj, Lumniye Guri, Ornela Leka, Arvit Osja, Gezim Galiqi, Erion Metushi, Elson Celiku, Oltion Luli, Julian Kraja, Anton Kaftalli, Hilmi Lakti, Marjan Ndershtiqaj, Sead Cocja, Gerald Hasaj, Lush Marku, Sokol Zaimaj, Sokol Zaimaj, Lulash Nika, Hekuran Gjorreta, Besmir Vukaj, Anton Deda, Andi Hallunaj, Lindita Nika, Nadir Spahija.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Korrik 2022".*
2. Pr/Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Gusht 2022".*
3. Pr/Vendim: *"Për miratimin e rregullores për marrëdhëniet e këshillit bashkiak me publikun dhe median"*
4. Pr/Vendim: *"Për miratimin e rregullores për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në Bashki"*
5. Pr/Vendim: *"Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2023-2025"*
6. Pr/Vendim: *"Për një ndryshim në VKB nr.3, datë 5.1.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër" (Rialokim)*

7. Pr/Vendim: "Për shtesë në buxhetin e vitit 2022, e miratuar me VKB nr.3, datë 5.1.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër"(Emergjencat Civile).
8. Pr/Vendim: "Për shtesë në VKB nr.3, datë 5.1.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër"(Arsimi)
9. Pr/Vendim: "Për shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar në VKB nr.3, datë 5.1.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër"(Shkresë nr.13629 dt.9.9.22)
10. Pr/Vendim: "Për shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar në VKB nr.3, datë 5.1.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër"(Shkresë nr.13630 dt.9.9.22)
11. Pr/Vendim: "Për miratimin e rishpërndarjes së fondit për mbrojtjen civile, Bashkia Shkodër.
12. Pr/Vendim: "Për një ndryshim në VKB nr.19, datë 10.5.2022 "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë"
13. Pr/Vendim: "Për shtesë në VKB nr.3, datë 5.1.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër"(korigjim emërtese)
14. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, kryetarja e këshillit hap mbledhjen duke sqaruar se rendit të ditës i është shtuar një pikë, konkretisht Pr/Vendimi: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Gusht 2022".

Hidhet në votim rendi i ditës, ku rezultojnë 40 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim. **Miratohet**
Kryetarja e këshillit propozon që dy pikat e para të rendit të ditës të relatohen së bashku, por votimi i tyre të kryhet ndaras.

Vijohet me pikën 1. të rendit të ditës: Pr/Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Korrik 2022".

Fjalën e merr Z.Deda, zv/kryetar i bashkisë, i cili relaton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Znj.Mandija në emër të komisionit shprehet pro të dy projekt vendimeve.

Projekt akti i parë hidhet në votim, ku rezultojnë 41 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 2. të rendit të ditës: Pr/Vendimi: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% për muajin Gusht 2022".*

Projekt akti i dytë hidhet në votim, ku rezultojnë 41 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 3 dhe 4. të rendit të ditës: Konkretisht, Pr/Vendim: *"Për miratimin e rregullores për marrëdhëniet e këshillit bashkiak me publikun dhe median"*

Pr/Vendim: *"Për miratimin e rregullores për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në Bashki"*

Këto dy pika janë dy rregulloret e fundit të Keshillit bashkiak.

Hidhet në votim rregullorja e parë, ku rezultojnë 40 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Hidhet në votim rregullorja e dytë, ku rezultojnë 40 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 5. të rendit të ditës: Pr/Vendim: *"Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2023-2025"*

Fjalën e merr drejtori i drejtorisë së të Ardhurave në Bashkinë Shkodër, Z.Kurti i cili relaton në mënyrë të detajuar sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Në emër të komisionit të buxhetit fjalën e merr Znj.Dibra e cila relaton në mënyrë të përmbledhur sipas relacionit të përgatitur nga komisioni ku ajo bën pjesë dhe shprehet pro këtij Pr/vendimi.

Z.Galiqi pyet relatuesin :Cfarë pune mendohet të bëhet për të rrit numrin e njerëzve kontribuues për taksën mbi pasurinë.Si mendohet të vilet kjo taksë ne të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër?

Z.Kurti përgjigjet që drejtoria që ai drejton po ndjek të gjitha procedurat ligjore për të arritur të rrisë sa më shumë numrin e njerëzve që paguajnë këtë detyrim, duke iu referuar ligjit përkatës dhe masave shtërnguese të tij.

Në emër të grupit të këshilltarëve të PSD, Z.Sokoli shprehet pro këtij Pr/vendimi.

Projekt akti i dytë hidhet në votim, ku rezultojnë 37 vota Pro, 1 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 6. të rendit të ditës: Pr/Vendim: *"Për një ndryshim në VKB nr.3,datë 5.1.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër" (Rialokim)*

Relaton përsëri Z.Dedaj duke sqaruar nevojën për shtesë në VKB nr.3 dt.05.01.2022.

Në emër të komisionit Znj.Dibra merr fjalën dhe shprehet se Projekt/akti sipas rekomandimeve të lëna është modifikuar, korrigtuar dhe ristrukturuar por komisioni ka një sygjërim për ekzekutivin

, meqënëse jemi në prag të dëgjësive publike, bashkia Shkodër të paraqesë një sistem pikëzimit të unifikuar për të përcaktuar prioritetet e financimeve në planin e buxhetit të vitit të ardhshëm. Komisioni shprehet dakord për këtë përvendim.

Fjala për Z. Marku i cili pyet Z. Deda se këto rialokime a shërbejnë për vazhdimin e projekteve të parashikuara apo për financim projektesh të reja? Ai sygjeron që punët dhe projektet e filluara duhen përfunduar para se të nisnin të reja.

Z. Luli drejton dy pyetje lidhur me infrastrukturën rrugore dhe atë sportive. Ai mendon që prioritetet janë korsitë e aksesueshme të bicikletave duke ditur se sa të shumta janë përdoruesit e tyre në Shkodër. Po ashtu edhe investimet për sallat dhe ambientet sportive në Shkodër lënë shumë për të dëshiruar. Prandaj ai mendon që në rialokime të tilla duhen pasur parasysh këto dy pika.

Z. Dedaj shprehet se lidhur me korsitë e bicikletave, vëmendja e kryetarit të bashkisë është maximale. Edhe në konferencën e donatorëve u kërkua diçka e tillë për shkak se Shkodrës i shkon për shtat një gjë e tillë edhe nga historiku i saj. Projekti po studiohet nga ekspertë të fushës dhe do shihet se kush është më i përshtatshmi. Kurse përsa i përket sallave sportive, financat nuk kanë qënë të mjaftueshme por së bashku me federatën kombëtare të futbollit ne do arrijmë të ndërtojmë salla dhe terrene sportive me bashkëfinancim.

Znj. Brigja shprehet në lidhje me prioritetet në investime. Ajo mendon që investimet në arsim duhet të jenë primare, duke ditur këtu problematikat e zonave rurale. Po ashtu ajo shpreh shqetësim edhe për infrastrukturën rrugore në zonën e saj të banimit.

Z. Dedaj rimerr fjalën dhe thotë se investimet janë të domosdoshme në çdo fushë dhe është mëse i drejtë shqetësimi i Znj. Brixha, por ne jemi në tratative për të gjetur donatorë për këto projekte.

Znj. Nika merr fjalën dhe thotë që investimet në arsim lidhen edhe me numrin e nxënësve. Unë mendoj që kopshtet dhe parashkollori duhen të shkëputen njëherë e mirë nga arsimi i lartë kur behet fjalë për investime.

Znj. Selimi shprehet në lidhje me investimet në shkollën "Azem Hajdari", ku ajo pyet se a mban kush përgjegjësi nga bashkia Shkodër për këtë dhe çfarë përgjigje mund t'i japin nxënësve tani që shkolla ka filluar dhe aty punohet për arsye keqlllogaritje.

Z. Dedaj shprehet se ndoshta ka patur një keqkuptim, sepse nuk ka patur një keqlllogaritje por rikonstruksioni i shkollës është projektuar me faza dhe vetëm tani është kryer edhe rialokimi i fondeve.

Kalohet në mendimin e Kryetarëve të grupeve, të cilët shprehet pro miratimit dhe mbështesin komisionin. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 37 vota Pro, 0 Kundër, 2 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 7. të rendit të ditës: Pr/Vendim: *“Për shitesë në buxhetin e vitit 2022, e miratuar me VKB nr.3, datë 5.1.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër” (Emergjencat Civile).*

Relaton përsëri nënkryetari i bashkisë ,Z.Dedaj sipas materialit të përgatitur nga administrata. Znj.Dibra në emër të komisionit të buxhetit thotë se për këtë nuk ka një relacion të detajuar por shpreh dakortësinë.

Z.Lakti në emër të komisionit për Emergjencat Civile shprehet pro duke theksuar se fondi për këtë është i vonuar, duke pasur parasysh që po hyjmë edhe në stinën e dimrit.

Kalohet në mendimin e Kryetarëve të grupeve ,të cilët shprehet pro miratimit dhe mbështesin komisionin. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 37 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën tjetër: 8. Pr/Vendim: *“Për shitesë në VKB nr.3, datë 5.1.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër” (Arsimi)*

Relaton në emër të administratës, sipas materialit të përgatitur Znj.Hila.

Merr fjalën Znj.Mandija dhe shprehet se në bashkëpunim me bashkinë Shkodër ato janë mundur të rrisi numrin e mësuesve mbështetës për fëmijët me aftësi ndryshe në kopshte dhe po punohet edhe për lehtësira financiare për to. Ato mbështesin unanimisht miratimin e këtij Pr/Vendimi.

Kalohet në mendimin e Kryetarëve të grupeve ,Znj.Dibra dhe Z.Sokoli shprehen pro miratimit . Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 36 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën tjetër: 9. Pr/Vendim: *“Për shitesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar në VKB nr.3, datë 5.1.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër” (Shkresë nr.13629 dt.9.9.22)*

Po ashtu edhe me pikën 10. të rendit të ditës: Pr/Vendim: *“Për shitesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër të miratuar në VKB nr.3, datë 5.1.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër” (Shkresë nr.13630 dt.9.9.22)*

Këtu kryetarja e Keshillit sqaron përsëri, që dy pikat në vazhdim do relatohen njëherazi por votimi i tyre do kryhet ndaras.

Fjalën e merr Znj.Bërdica, e cila relaton sipas materiali të përgatitur nga administrata.

Znj.Spahia pyet pse projekti është parashikuar në Dajc dhe jo diku tjetër?

Znj.Bërdica sqaron se Dajci është menduar si zonë që të ketë një qendër që do mbulojë gjithë zonën e Nenshkodrës.Ato mendojnë që kjo qendër do shërbejë edhe për viktimat e trafikimit edhe për Shkodrën duke mbuluar edhe shpenzimet për transportin.Synimi ka qënë shfrytëzimi i godinave në pronësi të bashkisë.

Znj.Nika shprehet se po të ishte bërë konsultim me ekspertë të arsimit do kishit kuptuar që ka mbivendosje shërbimesh sepse këto shërbime i ofron me ligj arsimi parauniversitar.Ajo dëshiron të dijë, cili ka qënë kriteri i ndjekur,që kjo qendër të bëhet pikërisht në Dajc.

Znj.Bërdica përgjigjet se kriteri bazë i përzgjedhjes ka qënë shfrytëzimi i aseteve të bashkisë duke kërkuar më tej fonde shtesë për shërbimin.

Znj.Mandija në emër të komisionit shprehet se pariumisht ato janë dakort por gjithmonë duke monitoruar zbatimin e këtij pr/vendimi.

Kurse Znj.Selimi shprehet se nuk është aspak dakort me kriterin e përzgjedhjes sepse sipas Censurit Dajci nuk rezulton si popullsi më të lartë.Ajo mendon se duhet të ishte përzgjedh një njësi me problematika më të mëdha në lidhje me fokusin e këtij projekti.Ajo shprehet dakort me Pr/vendimin e parë por totalisht kundra me të dytin.

Kalohet në mendimin e Kryetarëve të grupeve ,Znj.Dibra dhe Z.Sokoli shprehen pro miratimit të Pr/vendimit. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 33 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Në emër të komisionit Znj.Mandija shpreh dakortësi duke sqaruar edhe njëherë që njësia Dajc ka patur një godinë të gatshme për tu përdorur për këtë projekt.

Kalohet në mendimin e Kryetarëve të grupeve ,Znj.Dibra dhe Z.Sokoli shprehen pro miratimit të Pr/vendimit. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 32 vota Pro, 1 Kundër, 2 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 11. të rendit të ditës: Pr/Vendim: *“Për miratimin e rishpërndarjes së fondit për mbrojtjen civile, Bashkia Shkodër.*

Fjalën e merr Z.Dedaj, zv/kryetar i bashkisë, i cili relaton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Në emër të komisionit Z.Lakti shprehet pro këtij pr/vendimi. Po ashtu edhe kryetarët e grupeve shprehin dakortësi.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 31 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 12. të rendit të ditës: Pr/Vendim: *"Për një ndryshim në VKB nr.19,datë 10.5.2022"**"Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar,të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë"*

Përsëri relaton Z.Dedaj sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Kalohet në mendimin e Kryetarëve të grupeve ,Znj.Dibra dhe Z.Sokoli shprehen pro miratimit të Pr/vendimit. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 31 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 13. të rendit të ditës: Pr/Vendim: *"Për shtesë në VKB nr.3,datë 5.1.2022"**"Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër"**(korigjim emërtese)*

Relaton përsëri shkurtimisht në emër të administratës,sipas materialit të përgatitur Znj.Hila.

Mendimet e Kryetarëve të grupeve , Znj.Dibra dhe Z.Sokoli janë pro këtij Pr/vendimi. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 31 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në diskutime jashtë rendit të ditës.

Znj.Tyli merr fjalën dhe shpreh shqetësimin e komunitetit në lidhje me tre problematika.Së pari, me gjendje e Urës së Bunës.(Monument kulture) Së dyti:A ekziston një firmë kontraktoren për mirëmbajtjen e pemëve anash rrugëve të qytetit? Së treti:Shqetësim konstant mbetet zënia e ambjenteve publike.

Ajo drejton tre pyetje:1.Kur do zbatohet vendimi i miratuar nga Këshilli në lidhje me punonjësen mbështetëse në shkollën "13 dhjetori"? 2. Kush përgjigjet për mirëmbajtjen e monumenteve dhe objekteve të kulturës në Shkodër? 3.Në paketën fiskale është parashikuar heqja e taksave për nënat beqare ,a mund të dijë sa është numri i përfitueseve?

Znj.Tyli flet edhe për Aleancën e Këshillëtareve gra të bashkisë së Shkodrës dhe punën e tyre lidhur me barazinë gjinore dhe shërbimet që përfitojnë gra të shtresave të ndryshme të shoqërisë së qytetit të Shkodrës,si dhe takimet që ato bëjnë për t'i ardhur në ndihmë grave të qytetit dhe që zëri i tyre të dëgjohet.

Z.Dedaj përgjigjet pyetjes së parë; dhe thotëqë pastrimi tek Ura e Bunës kryhet shpesh dhe është në vëmendjen ton Po ashtu edhe për pemët është problematikë që zgjidhet lehtësisht nga firma e pastrim gjelbërimit kurse për hapqsirat publike,kemi problem me numrin e vogël të policëve bashkiak.Por do mbetet një mision parësor për ne.

Fjala është për Z.Hasaj,i cili shpreh disa shqetësime për Nj.Adm Rrethina.Si p.sh: venqëndrimi i koshave të mbeturinave.Një shtesë e kërkuar në shkollën “Sali Brucaj” dhe mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve të fshatrave.Ai kërkon të dijë pse kjo zvarritje dhe vonesë në kalimin e fondeve?

Z.Dedaj përgjigjet se për efektin e rialokimeve problematika ka gjithandej.Në Rrethina po punohet për rrugët dhe mirëmbajtjen e tyre,kurse në shkollën në fjalë investimi do fillojë në muajin Tetor.

Znj.Selimaj kërkon investim për një park lojrash dhe disa stola në lulishten e lagjes / komunitetin ky ajo banon. Bashkia ara pak kohësh, shprehet ajo ka rregulluar dhe pastruar lulishten tek tregu i Zdrales por sot ajo kërkon që të bëhet e aksesueshme për banorët aty.

Z.Dedaj shprehet plotësisht dakort që investime të tilla të vogla të parashikohen në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Z.Halluni dëshiron të ripërsërisë disa shqetësime të komunitetit.Njëri është pjesa e gjelbërimit,pemëve që janë rritur tej mase dhe bllokojnë pamjen për trafikun.Tjetër shqetësim është shkolla “Xheladin Fishta”,që ka një ambjen që akoma është e pronarëve dhe ndonjë kënd sportiv duke ditur edhe numrin e madh të nxënësve aty.Po ashtu shqetësim tjetër për Z.Halluni është edhe mospjesëmarrja në mbledhjeve të këshillit.

N/Kryetari përgjigjet që problemi i pemëve do zgjidhet menjëherë,kurse përsa i përket shpronësimit tek shkolla “Xh.Fishta” nuk mund të them asgjë pa u këshilluar më parë.

Z.Marku shprehet edhe njëherë dhe kërkon përfundimin e projektit që ka filluar kohë më parë dhe që po kthehet në shqetësim për banorët tek stacioni i trenit.Ai kërkon nga administrata që të marrë masa për përfundimin e tij sepse asgjë tjetër nuk funksionon pa u realizuar ky projekt.Duke filluar tek KUB,KUZ etj.

Z.Celiku merr fjalën dhe rikërkon përgjigje për një shkresë që ai ka bërë para disa kohësh në lidhje me shpërblimin e punëtorëve të zjarrefikësese.Ai kërkon marrjen e saj në konsideratë.

Z.Dedaj përgjigjet se përsa i përket shpërblimeve, punëtorët e MZSH-së mendoj që janë një nga administrata më elitare sepse marrin pagesa për orët shtesë,për vështërsitë dhe shpërblime të parashikuara me ligj.

Fjala për Z.Zaimi i cili thotë se i është premtuar për vendparkime me orar të përcaktuar për mësuesit e shkollës “Deshmorët e Prishtinës”,pasi ato shpesh herë ndeshën me gjoba dhe debate me punjosit e policisë rrugore.Ai kërkon studimin e vendit duke ditur që aty ka vend për vendparkime të tilla.Tjetër sygjërim i tij është që shkollat që kanë shumë gjelbërim t’i kalojnë për mirëmbajtje fëmës së gjelbërimit për punë më të specializuar.

Z.Dedaj shprehet se në lidhje me vendparkimet nuk mund të jap një përgjigje të saktë pa u konsultuar me drejtorin përkatës, kurse për gjetërimin ai thotë se firma ka një kontratë për punën e përcaktuar dhe e di nëse mund të bëhet kjo punë ekstra.

Znj.Kryetare e këshillit propozon që me dakortësi pyetjet që dalin jashtë endit të ditës të paraqiten paraprakisht në mënyrë që të marrin përgjigje sa më të saktë.

Edhe Z.Deda pohon një gjë të tillë, sepse ai nuk mund t'i përgjigjet pyetjeve që kërkojnë përgjigje teknike.

Znj.Lishi flet në lidhje me një shkresë të bërë shumë kohë më para ,për të cilën i është premtuar shtrimi i një rruge 30m pranë Autoshtollës Bushati.

Z.Dedaj kërkon shkresën dhe premtim që do merret personisht me çështjen.

Z.Metushi merr fjalën dhe flet shkurtimisht për një studim të bërë në lidhje me një projekt për një qytet ekologjik, duke vlerësuar këtë nismë dhe duke kërkuar vemendje dhe mbështetje nga këshilli dhe bashkia e Shkodrës.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Znj.Truma e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmblodhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 27.09.2022. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 9 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Denis LESH

KRYETARE

Brisela KADIJA

